




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Gjilan



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of

Gilan Belediyesi

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës, 01.Nr. 016-60481. të datës 30.05.2019 Drejtoria e Arsimit në Gjilan shpall:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË GJILANIT

- I. Sipas këtij konkursi ndahen 75 (Shtatëdhjetë e pesë) bursa për student të dalluar të Komunës së Gjilanit, për vitin akademik 2018/2019
- Pesëdhjetë (50) bursa në vlerë prej 60 €, për student të Komunës së Gjilanit që studiojnë në Universitetet e Kosovës, jashtë Komunës së Gjilanit;
 - Njëzet e pesë (25) bursa në vlerë prej 40 €, për student të Komunës së Gjilanit, që studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.

Kriteret e përgjithshme për të fituar bursën:

- Studentët që studiojnë në Universitetet Publike1 pikë;
- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit;
- Shfrytëzues të bursave studentore, mund të jenë vetëm studentët e rregullt me notë mesatare nga 7.0;
- Bursat do të ndahen vetëm për studentët që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve;
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës universitare apo ndonjë burse tjetër publike, nuk mund të jenë shfrytëzues edhe të kësaj burse;
- Studentët që janë në marrëdhënie të përhershme pune nuk mund të jenë përfitues të bursës;

Kriteret e veçanta për të fituar bursën:

- Poentimi do të bëhet në bazë të notës mesatare;
- Studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorëve
- Familjet që kanë 3 studentë e më tepër të rregullt
- Studentë i familjes me asistencë sociale

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Çertifikata e notave (origjinale)
2. Çertifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2018/2019 (i/e rregullt)
5. Vërtetimi që studentin nuk është përfitues i ndonjë burse;
6. Vërtetimi nga ATK që nuk është në marrëdhënie pune;

Vërejtje: Të gjithë ata studentë që nuk sjellin këto dokumente të kërkuara do të refuzohen

Dokumentet për poentim shtesë:

1. Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë i dëshmorit/es - poentimi 1 pikë
2. Vërtetimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2018/2019 – poentimi 1 pikë
3. Vërtetim se familja i ka 3 studentë në studime të rregullta dhe çertifikata e bashkësisë familjare – poentimi 1 pikë;

Vërejtje: Asnjë student nuk mund të poentohet më tepër se një pikë nga kriteret e veçanta

Bursat ndahen për afatin kohor: 01.09.2018 deri më 30.06.2019 (për dhjetë muaj)

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Nazim Gagica

